

1. Lexoji vjershat. Mësoji përmendësh.

1.

Në dhjetor bie borë.

Vjen një plak me shkop në dorë.

Një vogëlush vjen pas tij.

E ka emrin Viti i Ri.



2.

Mirësevjen, o Viti i Ri!

Shkëlqen bredhi me stoli.

Plot me lodra i mbuluar.


Plot me yje flakëruar.

Lart në maje ngjyra-ngjyra,

tullumbacet sa të fryra!

Rrotull bredhit jemi mbledhur,

me gaz vallen për ta hedhur.



3.

Viti i Ri, o Viti i Ri!

Çfarë dhuratash duam nga ti?

Duam paqe e lumturi

për Kosovë e Shqipëri.

